

PROCESVERBAL – Tipi i kontrates - Sherbime

PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM

(Ky procesverbal eshte per efekt publikimi bashke me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURES: “Mirembajtje e Programit te Faturimit Flare Billing per 12 muaj”.

KODI PERKATES NE FJALORIN E PERBASHKET TE PROKURIMIT (CPV):
Sherbimet e lidhura me softwaret - 72260000-5.

Ne baze te nenit 21, pika 2, te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, te V.K.M. nr. 285, date 19.05.2021, “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster ka hartuar procesverbalin per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve per kualifikim per proceduren e sipercituar, me permbajtjen si me poshte;

2. KRITERET E VEÇANTA TE KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet te paraqese:

- a. Formularin e ofertes , sipas shtojces 1
- b. Listen e cmimeve te sherbimeve , sipas shtojces 2
- c. Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces 9
- d. Sigurimin e Ofertes, sipas Shtojces 3;

***Argumentimi:** Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me nenin 82 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” dhe neni 83 “Sigurimi i ofertes”, te ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te nenit 30, pika 1, te VKM-se nr.285, date 19.5.2021, “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik: citojme neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet te kerkoje paraqitjen e sigurimit te ofertes nga ofertuesit ne te gjitha llojet e procedurave te prokurimit, me perjashtim te procedurave te prokurimit me vlere te vogel”, neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

2.1 Kapacitetin profesional te operatoreve ekonomike:

Sipas kritereve te pergjithshme te pranimit/kualifikimit, (Shtojca 9)

Operatori duhet te kete te perfshire ne objektin e veprimtarise ne Ekstraktin e QKB edhe objektin e prokurimit te kesaj kontrate.

Ofertuesi duhet te deklaroje se permbush kriteret e pergjithshme te pranimit/kualifikimit. Keto kritere duhet te plotesohen me dorezimin e vetedeklarates me shkrim te subjektit, ne ditën e hapjes se ofertes, sipas Shtojces 9.

Argumentimi: Kerkesa e mesiperme bazohet ne nenin 77, pika 1/a dhe 2, te LPP, nenit 41, pika 5, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", si dhe shtojces 9 te DST-se.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatoret ekonomike duhet te paraqesin vertetim per xhiron vjetore per 3 vitet e fundit financiare (2020,2021,2022) ku vlera e xhiros minimale vjetore per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se 20% e vleres se parashikuar te kontrates. Kerkesa per plotesimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e permbushur nese operatoret ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale, ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar nga autoriteti/enti kontraktor..

Argumentimi: Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, te LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b, neni 55 pika 4 germa b), te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik".

Percaktimi i vleres se kerkuar argumentohet si me poshte: " *Vlera e xhiros minimale vjetore qe u kerkohet operatoreve ekonomike nuk mund te tejkaloje:*

.... 20 % te vleres se parashikuar te kontrates, ne procedurat e prokurimit nen kufirin e ulet monetar". Kjo procedure eshte nen kufirin e ulet monetar dhe per kete arsye, vlera e xhiros minimale te kerkuar, eshte brenda kufirit te parashikuar ne dispozitat ligjore te sipercituara....

Si dhe neni 55/4....." Ne kete lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet te mbajne ne konsiderate te percaktojne kritere te thjeshtuara pranimi, me qellim nxitjen e pjesemarrjes se biznesit te vogel dhe te mesem.

Kerkesat ekonomike financiare duhet te kerkohen ne raport me objektin e prokurimit, duke marre ne konsiderate qe plotesimi i ketyre kerkesave mund te behet vetem me paraqitjen e xhiros vjetore te realizuar nga operatoret ekonomike. Vlera e xhiros se kerkuar ne kete lloj procedure prokurimi nuk mund te tejkaloje 20% te vleres se perlllogaritur te kontrates, sipas parashikimeve ne nenin 43, te ketyre rregullave."

Percaktimi i viteve te kerkuara per paraqitjen e vertetimit te xhiros vjetore eshte bere bazuar ne nenin 43, pika 2/b, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", si dhe ne legjislacionin e fushes ne fuqi, perkatesisht ne Ligjin nr. 8438, date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 date 29.12.2014 "Per deklarimin e

detyrueshem te deklarave tatimore dhe te dokumenteve te tjera tatimore, vetem nepermjet formes elektronike", si dhe ne Udhezimin e Ministrise te Financave nr.5, date 30.01.2006, "Per tatimin mbi te ardhurat", i ndryshuar. Ne çdo rast, kerkesa per plotesimin e kapaciteteve financiare do te konsiderohet e permbushur nese operatoret ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale, ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2. Pasqyrat financiare per vitet (2020,2021, 2022) te konfirmuara nga administrata tatimore. Ne rast se operatori ekonomik eshte ne kushtet e percaktimeve te nenit 41, te ligjit nr.10091, date 05.03.2009, atehere bilancet duhet te shoqerohen edhe me raportet e auditimit ligjor te pasqyrave financiare vjetore, te kryera, nga auditues ligjore ose shoqeri audituese. Kriteri konsiderohet i permbushur nese ne bilancet e kerkuara nuk ka raport negative ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kerkesa e mesiperme mbeshetet ne Nenin 77, pika 3, te Ligjit Nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik"; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik". Percaktimi i viteve te kerkuara per paraqitjen e bilanceve eshte bere duke iu referuar legjislacionit te fushes, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" (i ndryshuar).*

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Furnizime te meparshme te ngjashme me nje vlere jo me te ulet 20% te fondit limit te objektit te prokurimit, te realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, vertetuar me dokumentacionin vertetues si me poshte:

- per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates ose/dhe fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, ku shenohen datat, shumatat dhe sherbimet e realizuara.
- per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet te paraqese fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shenohen datat, shumatat dhe sherbimet e realizuara.

Argumentimi: *Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3 dhe neni 55 pika 4 germa b), te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"Per kontratat e mallrave dhe sherbimeve vlera totale e kerkuar duhet te jete ne nje vlere jo me te vogel se 20% te vleres se perllogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tri viteve te fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.*

Me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten, prandaj eshte kerkuar qe sherbimet e meparshme te ngjashme te jene ne vleren jo me pak se 40 % te vleres se fondit limit, qe eshte brenda vleres kufi te percaktuar ne nenin e sipercituar.

Percaktimi i vleres se kerkuar per kontratat e ngjashme eshte vendosur brenda kufirit te vleres te percaktuar ne rregullat e prokurimit publik dhe i sherben AK per te treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kane realizuar kontrata te ngjashme me objektin qe prokurohet, ne vlere jo me te vogel se 20 % te fondit limit, ne afat, me cilesi dhe rrit besueshmerine mbi pervojen qe ka ofertuesi ne treg. Pervoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbesor dhe si rrjedhim operatoret ekonomike duhet te paraqesin deshmi te tilla si referenca/fatura tatimore, per te provuar kryerjen e tyre qofte me sektorin privat dhe ate publik.

2.3.2 Operatori Ekonomik konkurues duhet te jete i certifikuar me:

- a. **ISO 9001 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilesisë) e perditësuar**
- b. **ISO 27001 (për Sigurinë e Informacionit) e perditësuar**
- c. **ISO 20000 (manaxhimi i sherbimeve IT), e perditësuar, e cila duhet te perkoje me kategorine dhe specifiken e produkteve dhe te sherbimeve qe prokurohen.**
- d. **BS PASS 99:2012 (Menaxhimi i sistemeve te integruar) e perditësuar**

Argumentim: Kërkesa më sipër është vendosur në mbështetje të nenit 36, pika 3, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku citohet:

“3.Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; 23 ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë Autoriteti Kontraktor kërkon garantimin e një shërbimi të vijueshëm dhe cilësor për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

... “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

a) ISO 9001, për sistemin e menaxhimit të cilësisë:

ISO 9001 (ose ekuivalente) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

b) ISO 20000-1 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të shërbimit të teknologjisë së informacionit:

Standardi ISO 20000-1 (ose ekuivalente) përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohen në teknologjitë e informacionit.

ISO 20000-1 është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomike për: ndjekjen konsistente të shërbimeve përgjatë afatit të zbatimit të kontratës, sipas kërkesave të DST-së.

Kjo certifikatë ose ekuivalentja e saj, siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet që do të realizohen përgjatë kohëzgjatjes së kontratës, do të menaxhohen sipas standardeve më të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

c) ISO 27001 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit:

ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- *mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.*
- *aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.*
- *aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.*
- *aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.*

Referuar sa më sipër cituar, ky standard i kërkuar, lidhet ngushtësisht dhe drejtpërdrejtë me zërat e kërkuara objekt kontrate.

d)BS PASS 99:2012 (Menaxhimi i sistemeve të integruar) e perditesuar:

Standarti BS PASS 99:2012 përcakton kriteret për menaxhimin e sistemeve të integruara. Certifikimit Menaxhimi i Integruar tregon se Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha kriteret.

2.3.3 **Per te vertetuar qe ka kapacitete njerezore, profesionale te mjaftueshme per realizimin ne kohe dhe sipas specifikimeve teknike te projektit, operatori ekonomik duhet te kete te punesuar te pakten 4 punonjes te diplomuar ne fushen e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj). Plotesimi i ketij kriteri duhet te vertetohet me paraqitjen e formulareve E-SIG per periudhen e 3 muajve te fundit duke iu referuar dates se hapjes se ofertave dhe diplomave te shkollimit te larte universitar per secilin prej punonjesve.**

***Argumentimi:** Kjo kerkese vendoset ne mbeshtetje te nenit 77 pika 1 e Ligjit Nr. 162 date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, ku parashikohet se:*

Autoritetet ose entet kontraktore percaktojne kerkesat per kualifikim per operatoret ekonomike bazuar ne:

- a) pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftesine teknike dhe profesionale.*

Per realizimin e ketij sherbimi kerkohet qe ne secilen nga fushat kryesore te projektit, operatori ekonomik te perdori personel teknik te mjaftueshem dhe te kualifikuar. Fushat e mesiperme te ekspertizes si dhe numri i personelit te certifikuar, jane kryer ne baze te komponenteve te projektit si dhe te mases se angazhimit te specialisteve. Diplomimi i punonjesve ne degjet Informatike ose Teknologji-Informacioni ose Elektronike, eshte kerkuar ne perputhje me objektin e prokurimit dhe termat e references pasi ky objekt prokurimi perfshine implementimin, adaptimin, testimin, migrim dhe instalimin e te gjitha informacioneve teknike te sistemit si dhe duhet te ofroje trajnim per perdoruesit.

a.Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar si “Ekspert te Çertifikuar” ne zhvillim dhe implementim e zgjidhjes se faturimit qe AK ka ne perdorim.

- Ky kriter te plotesohet me paraqitjen e certifikates perkatese per punonjesit

Argumentim: Qe te sigurohet nje mirembajtje sa me eficente e Programit te Faturimit qe shoqeria ka ne perdorim, zgjidhja ne kohe e problemeve, etj, kerkohet qe Operatori Ekonomik te kete te punesuar te pakten 2 punonjes te certifikuar nga prodhuesi i teknologjive baze te sistemit. Punonjesi i certifikuar ne zhvillimin dhe implementimin e zgjidhjes qe shoqeria ka ne perdorim “Flare Billing” ben te mundur qe zgjidhjet e probleme te behen brenda afateve te percaktuar ne SLA dhe ne kete menyre te mos krijohet asnje problematike ne sistemin e faturimit. Ne kete menyre AK ka garancine qe te njihet mire sistemi aktual i faturimit dhe tmos krijohet asnje problematike qe mund te sjelle nderprerje te proceseve te rendesishme te faturimit dhe ne kete menyre te AK te arketoje pagesat e kryera. Ekspertet e certifikuar bejne te mundur qe realizimi i kontrates dhe specifikimeve te saj te jete sa me i plote,shterues dhe ne afatet e percaktuara duke beret e mundur mbarvajtjen normale te procesit te punes.

b.Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1 specialist te certifikuar ne konceptet, inxhinierizimin e Web sherbimeve dhe protokollit SOAP. Keto certifikata garantojne qe programuesit jane te aftesuar ne zhvillimin e sistemeve me arkitekture te prirur drejt sherbimeve ne rrjet/sistemeve te shperndara.

-Ky kriter te plotesohet me paraqitjen e certifikates perkatesen per punonjesin.

Argumentim: Specialisti i sipercituar nevojitet per te garantuar integrimin mes sistemeve te brendshme dhe me sistemet e paleve te treta. Keto certifikata garantojne qe programuesit jane te aftesuar ne zhvillimin e sistemeve me arkitekture te prirur drejt sherbimeve ne rrjet/sistemeve te shperndara.

c.Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per menaxhimin e sherbimeve IT (ITIL ose ekuivalente)

- Ky kriter te plotesohet me paraqitjen e certifikates perkatese per punonjesin

Argumentim: Kerkesa per nje punonjes te certifikuar per "ITIL" ose ekuivalente lidhet me rezultatet qe duhet te permbushen nga Operatori Ekonomik, sipas kerkesave te shprehura ne DST ku percaktohen kohet e nderhyrjeve dhe termat e tjera te nivelit te sherbimit SLA (sherbimet e mirembajtjes).Nje çertifikim ITIL eshte nje set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh per realizimin e sherbimit ne teknologjine e informacionit dhe komunikimit, qe eshte pjese e qellimit te projektit te autoritetit kontraktor. Kerkesa per çertifikim ITIL ose

ekuivalente, i deshmon autoritetit qe operatori ekonomik, nepermjet stafit te certifikuar si me siper, garanton ideimin dhe konceptimin e sherbimeve IT te projektit ne menyre te menaxhueshme sipas standardeve nderkombetare te njohura, ne gjithe ciklin e tyre, perfshire ketu dhe sherbimet e mirembajtjes.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojces 9, te DT. Dokumentat e kerkuara me siper do te paraqiten nga OE i kualifikuar ne vend te pare perpara publikimit te njoftimit paraprak te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

Argumentimi: Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane stafin, personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontrates.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te paraqese autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i zgjidhjes "Flare Billing". Autorizimi duhet te permbajne te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. Ne kete autorizim duhet te perfshihen te dhenat e procedues : Nr i references , Data e procedures,Objekti i procedures, Autoriteti Kontraktor . Ne cdo rast duhet te paraqitet lidhja midis distributorit te autorizuar dhe prodhuesit.

Argumentimi: Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 40, pika 8, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, pervec kerkesave te parashikuara ne kete nen, mund te percaktoje kriteret tjera te vecanta, ne varesi te objektit qe prokurohet, te cilat i vlereson te nevojshme per ekzekutimin me sukses te kontrates”. Autorizimi i prodhuesit/distributorit te autorizuar, eshte nje dokument i rendesishem, pasi pervecse tregon origjinen e suportuesve qe kerkohen ne procedure, na garanton se ofertuesi eshte i autorizuar per ofrimin tek AK te ketyre sherbimeve. Kjo garanci lidhet njekohesisht edhe me treguesit cilesore te sherbimeve qe kerkohen te ofrohen e qe jane krijuar ne standardet apo prodhues te zyrtarizuar. Ky kriter eshte jo diskriminues, eshte ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates dhe lidhet drejtperdrejte me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine e OE ofertues per aftesite teknike. Kjo kerkese i sherben autoritetit kontraktor per njohjen e mundesise se OE-se per permbushje me sukses te kontrates.

Duke pasur parasysh dinamiken e punes se stafit te shoqerise, shtrirjen gjeografike te shoqerise, problematikat qe mund te dalin gjate perdorimit te programit te Faturimit kerkohet qe Autoriteti Kontraktor te jete i garantuar qe Operatori Ekonomik ka mbeshtetjen dhe suportin e prodhuesit per te mirembajtur kete program.

2.3.4 Operatori Ekonomik pjesmarres duhet te paraqese nje oferte teknike te detajuar per te gjithe kerkesat e percaktuara ne termat e references. Oferta teknike duhet te konsistoje minimalisht ne:

- Pershkrim zgjidhje teknike te gjithë kerkesave teknike te specifikuara ne Termat e References.

Shenim: Pergjigje copy-paste te kerkesave nuk do te pranohen (duhen pergjigje te argumentuara per cdo kerkese te parashikuar ne Termat e References).

***Argumentimi:** Kjo kerkese vendoset ne mbeshtetje te nenit 41, pika 4 ç) te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, te ndryshuar. Ne pergjigje te kerkesave te termave te references, kerkohet qe Ofertuesi te paraqese zgjidhjen e tij per secilen kerkese. Keto zgjidhje kerkohet te percaktohen ne formen e pergjigjes per çdo pike/kerkese te ToR. Pergjigjet duhet te argumentohen ne zgjidhjen specifike te ofertuar.*

Ky kriter eshte vendosur per te garantuar aftesine e Operatorit Ekonomik per te realizuar ne kohe dhe me cilesi implementimin e zgjidhjes se ofruar dhe realizimin e te gjitha kerkesave te tjera te percaktuara ne Specifikimet Teknike dhe Termat e References. Nepermjet ofertes Teknike AK do te kuptoje shume me qarte qe OE i ka kuptuar kerkesat dhe funksionalitetet e percaktuara ne Termat e References dhe ne kete menyre kuptohet dhe menyra se si do te realizohen detyrat e percaktuara.

Argumentimi i specifikimeve teknike dhe termave te references:

Specifikimet teknike jane hartuar nga struktura te specializuara/ Grup pune per objektin qe prokurohet, i ngritur me Urdher te Titullarit per hartimin e specifikimeve teknike/ termave te referencave, ne perputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, te LPP, si dhe nenit 41, pika 1, te VKM nr. 285, date 19.05.2021, “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kerkese funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard te kerkuar**, ku çdo reference duhet te shoqerohet nga fjalet “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike te ketij sherbimi, jane hartuar ne perputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, te LPP, si dhe nenit 41, pika 1 dhe 2 te VKM nr. 285, date 19.05.2021, “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” (i ndryshuar), me qellim permbushjen e objektivave te kontrates, qellimit dhe rezultateve qe pritet te arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe OE te marre masat ne kohen e duhur qe te garantoje kapacitetet per permbushjen me sukses te kontrates sipas kushteve te percaktuara.